



Data: 05.04.2019

Ref.: 566/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 66-të, të mbajtur më 27 mars 2019, mori:

### V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Nr.486/19H, datë 22.03.2019 e Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli", si e bazuar.
- II. Ndryshohet pika I (një) e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.310/19D, datë 22.02.2019.
- III. Aprovohet aplikacioni i Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli", për akreditim të programeve të studimit, Energjia, Eficienca dhe Mjedisi, Bachelor Profesional, 180 ECTS.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.310/19D, datë 22.02.2019 mbetet e pa ndryshuar.

### Arsyetimi

KSHC me vendim Nr. 310/19D, datë 22.02.2019 ka refuzuar aprovimin e aplikacionit për programet e studimit, Energjia, Eficienca dhe Mjedisi, Bachelor Profesional, 180 ECTS, Menaxhimi dhe Ekonomia e Transportit, Bachelor Profesional, 180 ECTS, dhe Inxhinieria e Aplikuara Kompjuterike, Bachelor Profesional, 180 ECTS.

Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli", brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.310/19D, datë 22.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 22.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).

Përmes kësaj ankesa, Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programet e studimit,

Energjia, Efiçienca dhe Mjedisi, Bachelor Profesional, 180 ECTS, i cilat kanë qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.310/19D, datë 22.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 66-të të KShC-së, të mbajtur me 27 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programin e studimit, Energjia, Efiçienca dhe Mjedisi, Bachelor Profesional, 180 ECTS, i plotësojnë kushtet për të qen bartës të programit të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli";
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

